REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Propozimet
e
Ministrisë së Shtetit
për
Mbrojtjen e Sipërmarrjes
II
(Janar-Prill)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Asnjë vend nuk ka mundur të shënojë rritje ekonomike, pa një shtet të fortë i cili të partnerizojë me sipërmarrësin duke ofurar të mira publike kyçe si dhe të hartojë politika favorizuese ndaj biznesit. Shqipëria tashmë ndodhet në një moment themelor për të ardhmen e saj ekonomike. Angazhimet e ndërmarra në kuadrin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, ndjekur nga aksioni kundër informalitetit, si dhe reforma e deregulimit shoqëruar me lehtësimin e procedurave dhe burokracive në administratë, janë tregues i qartë i vullnetit të kësaj Qeverie për ta shndërruar Shqipërinë në portë hyrëse në trëgëtinë rajonale.

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në kuadër të bashkëqeverisjes, përmirësimit të klimës së biznesit dhe uljes së problematikave që ky i fundit has, organizoi pëtgjatë muajve mars dhe prill 9 tryeza sektoriale ndërmjet grupeve të interesit dhe Institucioneve përgjegjëse për secilën nga fushat ku sipërmarrja ushtron aktivitetin në Shqipëri. Biznesi dhe tërë grupet e interesit bashkërenduese me këtë sferë, janë të mirëorganizuar dhe një pjesë e madhe syresh nuk kanë hezituar të ofrojnë ekspertizën më të mirë nëpërmjet matricave të paraqitura për diskutim.
Nga 81 propozimet e formuluara gjatë këtyre treyzave, 32 syresh u morën përsipër nga zv. ministrat përkatës për t'u ndjekur në hallkat e tjera drejt implementimit final të tyre, duke shënuar një marzh suksesi prej 40%.

Rekomandimet e shtruara në vijim të këtij dokumenti vijnë si rrjedhojë e një sinergjie shumë palëshe, rezultat i një ndër objektivave kryesorë në themel të krijimit të këtij institucioni, nxitjes së transparencës dhe përmirësimit të komunikimit. Ato janë të grupuara sipas fushave kryesore që preken nga implementimi i tyre dhe synojnë përmirësimin e klimës së biznesit në sektorët specifikë.

Ky guideline propozues është i dyti i prodhurar nga Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, dhe do të pasohet nga të tjerë që po ashtu do të botohen në mënyrë periodike në faqen zyrtare ëëë.sipermarrja.gov.al
Zyra jonë është e hapur në cdo kohë për cdo sipërmarrës të huaj apo vendas që has në pengesa të pajustifikueshme, nëpërmjet kontaktit në faqen tonë zyrtare, adresës elektronike info@sipermarrja.gov.al dhe portalit e-albania.

Së fundmi gjejmë rastin të falenderojmë të gjithë komunitetin e biznesit në Shqipëri, për kontributin dhe mbështetjen e ofruar.

PASQYRË LËNDE

1. KLIMË BIZNESI

Konsultimi Publik

2. DOGANA

Procedura Doganore

3. INSPEKTORATE

Inspektimi Online

4. AGROBIZNES

Eliminim i Detyrimeve të Prapambetura

5. KODI I PUNËS

Rishikim i disa Neneve

6.MJEDISI

Riciklimi mbetjeve

7.TATIME

Procedura tatimore

8. LEJE, LICENSA, AUTORIZIME

Publikimi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve

9. PROPOZIMET E PARAQITURA GJATË TRYEZAVE SEKTORIALE

KLIMË BIZNESI

Konsultimi publik

Mos zbatimi i vazhdueshëm i procesit të konsultimit paraprak dhe përgjatë miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore me grupet e interesit është një realitet i cili shkakton problematika të qenësishme tek sipërmarrja, e cila kësisoj nuk përfshihet konkretisht në proceset vendimmarrëse.

Argumentim

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes propozon ndryshim në ligjin për konsultimin publik duke bërë ndërhyrje për penalizimin individual të çdo zyrtari publik që nuk e zbaton ligjin per konsultimin **"Ligji nr. 146, date 2014, per njoftimin dhe konsultimin publik".**

Propozim

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes propozon shtimin e një dispozite ligjoren në ligjin "**Ligji nr. 146, date 2014, per njoftimin dhe konsultimin publik**" e cila të përfshijë masën e gjobës e duke e përshkallëzuar deri në masë disiplinore mozbatimin e procesit të konsultimit paraprak nga ana e zyrtarëve publik.

DOGANA

Procedura doganore

Sipërmarrja ka denoncuar në mënyrë përgjatë këtyre gjashtë muajve probleme të vijuara me procedurat doganore sa i takon penaliteteve të vendosura dhe procedurës së të drejtës së ankimimit.

Argumentim

Rishikimi i ligjit për procedurat doganore mbi penalitetet dhe të dretjën e ankimimit me qëllim unifikimin e këtyre percaktimeve sipas ligjit p
ër procedurat tatimore. Konkretisht neni 289, pagesa e detyrimit dhe 40% e gjobës para ankimit në gjykatë. Unifikimi i ligjit me procedurat tatimore do të sillte në një mbarëvajtje në uljen e problematikave të sipërmarrjes dhe si rrjedhojë përmirësim të klimës së biznesit.

Propozim

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes propozon rishikimin e ligjit për procedurat doganore nëpërmjet unifikimit të procedurave doganore me procedurat tatimore, të cilat parashikojnë pagesën e detyrimit dhe jo penalitetit.

INSPEKTORATE

Inspektimi online

Grupe interesi të ndryshme gjatë tryezave të zhvilluara kanë raportuar si problematike ndërprerjen e procesit të inspektimit "online" në të gjithë fushat e inspektimit dhe gjithashtu problemet e vazhduara me mbivendosjen e kompetencave të inspektimeve të ndryshme. Shpesh shfaqet mbivendosje në fushat e kontrollit ndërmjet inspektorateve.

Argumentim

Rishikimi i ligjit për inspektimin, në kuadër të Reformës së Derregullimit, duke parashikuar shtrirjen e procesit së inspektimit online në të gjithë fushat e inspektimit, si skemë që mbështet dhe garanton transparencën, rrit for
malizimin në ekonomi dhe nxit konkurrueshmërinë e tregut.

Propozim

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes propozon rishikimin e
Ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, për parashikimin e inspketimit online në të gjitha fushat e inspektimit.

AGROBIZNES

Eliminim i detyrimeve të prapambetura

Detyrime të shumta të prapambetura për disa qindra fermerë e subjekte të agrobiznesit të rezultuara nga një grant i dhënë në mbështetje të fermerëve shqiptarë nga qeveria e Japonisë në vitet 1999-2005.

Argumentim

Hartimi i një ligj i veçantë i cili të parashikojë për subjektet pasive për më shumë se 2 vite, fshirjen e detyrimit i cili nuk ka asnje mundesi mbledhje dhe çrregjistrimi i tyre nga te gjithe database e administrates shteterore, me qellim mbylljen e detyruar te tyre.

Propozim

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes rekomadon rishikimin e **Ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"** për fshirjen e detyrimeve të prapambetura për disa qindra fermerë e subjekte të agrobiznesit, subjekt i grantit në mbështetje të fermerëve Shqiptarë nga qeveria e Japonisë në vitet 1999-2005.

KODI I PUNËS

Rishikim i disa neneve

Janë raportuar problematika sa i takon zbatimit të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore pasi krijon vështirësi dhe pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të sipermarrjes prodhuese.

Argumentim

Përmirësimi i vazhdueshëm i Kodit të Punës në përputhje me nevojat bashkekohore të një tregu dinamik, është i nevojshëm për lehtësimin e klimës së biznesit dhe optimizimin e kapacitetit prodhues të sipërmarrjes.

Propozim

Rishikimi i Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë LIGJ Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar në disa nene të tij, përshembull:

* Rishikimi i 58 neneve që përcaktojnë gjoba për bizneset.
* Rishikim i masave të gjobave. (Nisin nga 20 rroga mujore deri në 250 rroga mujore.)
* Fleksibilitet më i lartë në zbatimin e orëve minimale, orëve jashtë orarit, dhënies së pushimeve.
* Lehtësimi i bizneseve nga detyrimet e kontrolleve mjekësore për punonjësit, përfshirë vendosjen e mjekut.

MJEDISI

Industria e riciklimit

Janë raportuar në mënyrë të vijueshme problemet që krijon legjislacioni në fuqi sa i takon lejimit të eksportit të mbetjeve plastike dhe letër, si lëndë të para për industrinë e riciklimit.

Propozim

Të kufizohet eksporti i mbetjeve plastike dhe letër të cilat konsiderohen si lëndë të para për industrinë e riciklimit, përderisa ndalohet importi i tyre. Çështja kërkon artikulim ligjor dhe procedurial nëpërmjet rishikim të **Ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjev**e".

LEJE, LICENSA E AUTORIZIME

Publikimi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve

Nënvizohet detyrimi për zbatimin e dispozitave ligjore dhe publikimin në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve të vendimev përkatëse. Nevoja për vëmendje vjen nisur nga një kërkesë e kryer më datë 19/06/2017 nga subjekti X, i cili ka paraqitur kërkesën për pajisjen me licencën "Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada", dhe nuk ka patur mundësinë e leximit në sistemin online të kësaj kërkese.

Argumentim

Bazuar në nenin 14, të **Ligjit Nr. 10081, datë 23/02/2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se "çdo kërkesë për pajisjen me licencë/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të dhe çdo licencë/leje të dhënë e të vlefshme publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, i cili është lirisht i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi."

Propozim

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes rekomandon që në cilësinë e institucionit tjetër përgjegjës për vendimmarrjen në fushën e shërbimeve portuale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikes duhet te publikojë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve vendimet në lidhje me këto licensë.

TATIME

Procedura tatimore

Një nga kërkesat e sipërmarrjes që punon nën regjimin e përpunimit aktiv (fason) është përjashtimi i nënkontraktorëve nga TVSH-ja. Subjektet primare që furnizojnë të tretët i paguajnë ata pa TVSH-në (d.m.th 20% më pak) me premtimin që TVSH-në do t'ia kalojnë kur të rimbursohen nga shteti. Si rrjedhojë, subjektet e vogla marrin më pak para dhe janë në varësi të kontraktorit kryesor. Subjektet që furnizojnë të tretët automatikisht duhet ta kalojnë pjesën e kontrollit, që të marrin rimbursimin e TVSH-së. Në këtë mënyrë nënkontraktori pret kontraktorin dhe ky i fundit pret qeverinë, duke krijuar kështu vonesa në pagesa që kanë vënë në vështirësi nënkontraktorët, teksa kjo e ardhur e munguar është zë i fuqishëm i tyre.

Argumentim

Ky ligj, sikurse dihet, synon harmonizimin dhe përputhshmërinë e tij me dispozitat e Direktivës së Këshillit 2006/112 datë 28.11.2006, "Për Sistemin e përbashkët të TVSH-së", të konsoliduar. Ligji i ri për TVSH ka një ndryshim shumë të rëndësishëm për sektorin e regjimit të përpunimit aktiv (fason). Ky ndryshim ka të bëjë me marrëdhëniet me nënkontraktorët. Ai konsiston në heqjen e statusit si "i përjashtuar nga TVSH" për nënkontraktorët, të cilët me këtë status nuk e faturonin TVSH për shërbimin dhe gjithashtu nuk rimbursonin TVSH për blerjet.

Propozim

Në **Ligjin nr. 92/2014, dt 24/07/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ", në Nenin 54 "Të tjera përjashtime nga TVSH-ja"**, të parashikohet:

Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u rieksportuar për personat e tatueshem të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, është furnizim i përjashtuar.

Propozimet e paraqitura gjatë Tryezat Sektoriale

Në kuadër të tryezës sektoriale për mjedisin, janë paraqitur disa propozime, përkatësisht:

- *Ndërmarrja e nismave përmes ndërgjegjësimit dhe edukimit duke vendosur në kurikulat shkollore të lëndës Edukatë Mjedisore, me qëllim nxitjen e ndarjes së diferencuar t ë mbetjeve që në burim.*

- *Ndërmarrja e nismave për ndryshimin e Kodit Penal mbi krimet mjedisore.*

- *Plotësimi i kuadrit ligjor mbi akte nënligjore të tilla si hartimi i parametrave për shkarkimet në ajër apo për kushtet fizike dhe teknologjike për pikat e grumbullimit të skrapit.*

- *Në kuadër të transparencës dhe bashkëpunimit, propozohet që çdo nismë ligjore të dërgohet për mendim MSHMS, me qëllim që të kërkohet dhe mendimi i grupeve të interesit.*

- *Ndërmarrja e masave nga ana e Qeverisë për të siguruar lëndën e parë industrisë së riciklimit që të mos falimentojë.*

- *Krijimi i një mundësie për vendosjen e një personi të grupeve të interesit pranë MTM, për të dhënë informacion për çdo vendim apo udhëzim që iniciohet.*

- *Propozohet që për objekte në proces legalizimi që ndodhen në zona ku kryhen aktivitete si nxjerrje përpunim minerare, gurore, apo aktivitete të ngjashme, të mos legalizohen nga ana e ALUIZNI.*

- *Të rishikohet si koeficient rikuperimi i fondit pyjor që dëmtohet nga veprimtaria e sipërmarrjeve.*

Në kuadër të tryezës sektoriale për infrastrukturën, janë paraqitur disa propozime, përkatësisht:

- *Ndërmarrja e nismave për të ngritur një institucion që inspekton ashensorët dhe sigurinë e tyre.*

- *Ndërmarrja e nismave për të ngritur Institutin e kërkimeve strukturore për infrastrukturën me qëllim që të rritet cilësia në investime.*

- *Bërjen e ndryshimeve në ligjin "Për Prokurimin Publik", përkatësisht me përdorimin e "marrëveshjes kuadër për projektim" duke e shfuqizuar apo ndryshuar.*

- *Vendosja e një standarti për prezantimin e një projekti, duke nisur që nga projeksioni.*

- *Japin mendimin për ngritjen e një mekanizmi dhe vendosjen e një tarife për konsulencën në termat e referencës.*

Në kuadër të tryezës sektoriale për punëisimin të zhvilluar janë paraqitur këto propozime:

- *Konsulenca e sipërmarrjes në hartimin e Planit Kombëtar për nxitjen e punësimit, mbi masat që marrin institucionet për të nxitur krijimin e vendeve të reja të punës, si me poshtë:*

- Në identifikimin e grupeve që kanë vështirësi në integrimin në tregun e punës, mbështetur në moshën, gjininë, nivelin arsimor.
- Në identifikimin e formave "horizontale" për gjenerimin e vendeve të punës nga sektori privat, në nivele sektoriale.
- Në reformën për ndërhyrje në kuadrin ligjor për sa i përket konkurrencës, ndërhyrje në sistemimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore etj.
- Në krijimi i katalogut të ndërmarrjeve që mbahet nga NQV.
- Në identifikimin e nevojave sektoriale per formim profesional. Vënia në funksion të bordeve të shkollave profesionale me dy përfaqësues nga biznesi, njëri prej të cilëve dhe kryetar i saj.
- Në shqyrtimin dhe mundësimin e edukimit profesional, nëpërmjet, përditësimit te kurikulave profesionale. Rikthimi në funksion të Institutit të kurrikulave dhe mekanizmit të kontrollit për mënyrën si organizohet mësimi. Binjakëzimi i shkollave profesionale vendase me shkolla europiane.

- *Krijimi i mundësisë ligjore që profesionist të kenë mundësinë të japin mësim pa i penguar nga puna e tyre private.*

- *Ndërmarrja e nismave për të bërë të detyueshme pagesat për Dhomat, me qëllim fuqizimin e tyre për të bërë konsulenca dhe përgatitje ligjore.*

- *Rishikim të legjislacionit për sa i përket punonjëve me kohë të pjesshme.*

- *Nevojën për vetfinancim të shkollave profesionale, pra që një pjesë të punëve të kryhen nga studentët vetë dhe jo të paguhen persona të jashtëm.*

- *Alokuimi i fondeve minimale për laborator.*

- *Rishikim të legjislacionit për fleksibilitetin e punës për orët e punës dhe për orët e punës j ashtë orarit.*

- *Rishikim të penaliteteve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe për mos njoftimin e zyrave të punës për një vend pune të lirë.*

- *Ndërmarrja e nismave që përmirësojnë klimën e të bërit biznes, stimulimin e të rinjve dhe të hartimi i një politikë fiskale afatgjatë.*

- *Subvencionimi në shuma të ulta i bizneseve të vogla në fazat e para të saj.*

- *Hartimi i instrumentave për qasje ne financime, përmes depozitimit të një fondi garancie nga Qeveria në banka për hapat e para të bizneseve të tilla.*